



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË

VENDIM

Nr 71 Datë 18. 7. 08

PER

Miratimin e kontributit financiar të Bashkisë ndaj shoqërisë
“Administrim i Mbetjeve Urbane , Qarku Korçë”.

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Finances ‘Per miratimin e kontributit financiar të Bashkisë ndaj shoqërisë « Administrimi i Mbetjeve Urbane, Qarku Korçë », bazuar në ligjin nr. 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 32 pika dh, ligjin nr.9836 dt. 26.11.2007 « Per buxhetin e Shtetit te vitit 2008 », Udhezimin nr.4 dt.17.01.08 i M.F « Per zbatimine buxhetit te shtetit per vitin 2008 ».Udhezimin nr 258 dt. 15.02.2008 i Ministrise se Brendshme « Per zbatimin e buxhetit te qeverisjes vendore per vitin 2008 », V.K.B nr. 12 dt. 18.03.2008 « Mbi miratimin e buxhetit te Bashkise dhe institucioneve te vartesis se per vitin 2008 », mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

- 1.Të miratoje kontributin financiar të Bashkisë për 6-mujorin e parë të veprimtarisë të shoqërisë **KRWM** në vlerën **1.573.455 lekë**.
2. Kontributi në këtë vlerë do të përdoret për të përballuar shpenzimet për paga, sigurime shoqërore dhe shpenzime operative.
3. Ky fond do të përballohet nga fondi i planifikuar në buxhetin e Bashkisë për vitin 2008 në zërin “ Studime e projekte”, me këtë strukturë buxhetore:

Pakesohet	00	01110	05	Art 2302100	-	1 573.455 lekë
Shtohet	00	01110	05	Art 6040009	+	1 573 455 lekë

- 4.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës.
- 5.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Këshillit
Raimonda Nase
Raimonda Nase